



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:162604

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05684836

C.nr.596/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri me bashkëpunëtorin profesional Liman Javori, në çështjen juridike të paditësit B. K. me adresë banimi në Ll./Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Avdullah Hoti avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike: “Kompensim i mjeteve financiare të udhëtimit”, vlera e kontestit 242.20 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 15.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B. K. me adresë banimi në Ll./Malishevë, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit që në emër të shpenzimeve të udhëtimit, paditësit **B. K.** t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 242.20 euro (dyqind e dyzet e dy euro, e njëzet cent), dhe atë:
- a) Për udhëtim nga vendbanimi i tij në Llashkadrenoc e deri në SHFMU “Imer Krasniqi” në Carallukë/Malishevë, për periudhën nga viti shkollor 2017 deri 2020 ose për gjithsejtë 122 ditë pune, të përlllogaritur nga 0.70 euro për një ditë pune, në 70% të biletës (1 euro bileta për një ditë vajtje-ardhje), pra $0.70 \text{ euro} \times 122 \text{ ditë pune} = 85.40 \text{ euro}$ dhe
- b) Për udhëtim nga vendbanimi i tij në Llashkadrenoc e deri në SHFMU “Migjeni” në Lubizhdë/Malishevë, për periudhën nga viti shkollor 2017 deri 2020 ose për gjithsejtë 224 ditë pune, të përlllogaritur nga 0.70 euro për një ditë pune, në 70% të biletës (1 euro bileta për një ditë vajtje-ardhje), pra $0.70 \text{ euro} \times 224 \text{ ditë pune} = 156.80 \text{ euro}$, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data e marrjes së aktgjykimit dhe në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- II. OBLIGOHET** e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë shumën prej 78.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro, ose gjithsejtë shumën prej 99.00 euro.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi B. K. me adresë banimi në Ll./Malishevë, përmes të autorizuarit të tij Avdullah Hoti avokat nga Prishtina, në këtë gjykatë me datë 19.07.2021 ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i mjeteve financiare të udhëtimit. Sipas padisë, paditësi është i punësuar prej vitit 2011 në SHFMU “Imer Krasniqi” në fshatin Carallukë/Malishevë dhe në SHFMU “M.” në Lubizhdë/Malishevë, në cilësinë e mësimitdhënësit.

Ka theksuar se paditësi në bazë të vërtetimeve për ditët e punës të lëshuara nga drejtoria e dy shkollave, për periudhën 2017-2020 i ka gjithsejtë 364 ditë pune dhe lidhur me këtë, ka bërë kërkesë për kompensimin e mjeteve financiare të udhëtimit në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Malishevës, por e njëjta është refuzuar me arsyetimin e mungesës së mjeteve financiare dhe mos planifikimeve buxhetore, ndërsa paditësi ka pretenduar se i takojnë këto mjete financiare duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës me dispozitën e nenit 35 par. 5 të vitit 2017 si dhe me nenin 90 të Ligjit të Punës.

Ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija dhe të detyrohet Komuna e Malishevës-Drejtoria e Arsimit që ta përmbushë obligimin në lartësi prej 254.80 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data e marrjes së aktgjykimit.

I autorizuari i paditësit përmes parashtrësave të datës 09.11.2022 dhe 27.12.2022 ka bërë precizimin e padisë duke ia bashkangjitur parashtrësave edhe vërtetimet e punës me nr. prot.... të datës 02.11.2022 dhe nr. prot.... të datës 13.10.2020, ashtu që i ka specifikuar ditët e punës dhe ka shtuar se paditësi B.K.për periudhën-vitin shkollor 2017 deri me 2020 në SHFMU “Imer Krasniqi” në Carallukë i ka gjithsejtë 122 ditë pune, kurse për periudhën e njëjtë në SHFMU “Migjeni” në Lubizhdë i ka gjithsejtë 224 ditë pune, pra në të dy shkollat i ka gjithsejtë 346 ditë pune.

Pra, tani në precizim ka sqaruar se i ka gjithsejtë 346 ditë pune, e jo 364 dhe se për shpenzime të udhëtimit i takojnë 242.20 euro, të gjitha këto të përlllogaritura sipas udhëtimit ditor në relacionin Llashkadrenoc-Carallukë dhe anasjelltas dhe Llashkadrenc-Lubizhdë dhe anasjelltas, duke e llogaritur në 70% të biletës 1 euro vajtje-ardhje, e cila rezulton të jetë 0.70 cent/euro (0.70 euro x 346 ditë pune = 242.20 euro).

Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj të bazuar kërkesëpadinë si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, për përpilimin e precizimit të padisë shumë prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 21 euro.

E paditura përmes përgjigjes së saj në padi, ndër të tjera ka theksuar se kërkesa e paditësit është në kundërshtim me kontratën kolektive për faktin se paditësi nuk ka ofruar prova se nga cili relacion udhëton dhe në çfarë kohe, por ka ofruar vetëm dy bileta të autobusit.

Komuna e Malishevës e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga

MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi, pasi që palët të cilat e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjitha kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me datën 21.11.2022 për shkëputjen e kësaj kontrate, dhe po ashtu MAPL ka bërë njoftimin për kryetarët e komunave për shkëputjen e kësaj kontrate.

Në fund i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj si të pabazuar padinë e paditësit, ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj qeverisë së Republikës së Kosovës-MASHT.

Provat e administruara dhe vlerësimi i tyre

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i ka shqyrtuar këto prova dhe atë: Kontratën e Punës nr. 11/191 të datës 06.03.2019, certifikatën e vendbanimit me nr. ser. B 10285714 të datës 09.10.2020, kërkesën për kompensimin e mjeteve drejtuar Drejtorisë së Arsimit në Malishevë e datës 03.11.2020, përgjigja ndaj kërkesës nga Drejtoria e Arsimit nr.11/1159 e datës 30.11.2020, biletat e udhëtimit-kuponët fiskal të lëshuara nga N.T.T “Korabi Tours 1”, vërtetimet mbi punësimin dhe përvojën e punës nr. prot.968/2 të datës 08.10.2020, nr. prot... të datës 13.10.2020, nr. prot.682/1 të datës 09.10.2020, vërtetimin për ditët e punës nr. prot.... të datës 02.11.2022 dhe vërtetimin nr. prot.... të datës 13.10.2020 të gjitha këto të lëshuara nga drejtoria e dy shkollave, si dhe kopjen e letërnjoftimit.

Ndërmjet palëve nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune në pozitën mësimdhënës i lëndës së kulturës fizike në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët SHFMU “Imer Krasniqi” në Carallukë dhe SHFMU “Migjeni” në Lubizhdë/Malishevë, shkolla këto të cilat bien në kompetencë të të paditurës dhe kjo është vërtetuar me kontratën e punës nr.... të datës 06.03.2019 dhe gjithashtu edhe me vërtetimin me nr. ... të datës 08.10.2020, vërtetimin nr. prot.68/20 të datës 13.10.2020 dhe vërtetimin me nr. prot... të datës 09.10.2020.

Nga parashtrësat për precizim të ditëve e punës, dhe me vërtetimet me nr. prot.999/2 të datës 02.11.2022 dhe nr. prot.68/20 të datës 13.10.2020 të lëshuar nga drejtoria e SHFMU “Imer Krasniqi” në Carallukë dhe drejtoria e SHFMU “Migjeni” në Lubizhdë, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura nga viti 2011 respektivisht 2017 dhe për periudhën-vitin shkollor 2017 deri 2020 në SHFMU “Imer Krasniqi” në Carallukë i ka gjithsejtë 122 ditë pune, kurse për periudhën e njëjtë në SHFMU “Migjeni” në Lubizhdë i ka gjithsejtë 224 ditë pune, pra në të dy shkollat i ka gjithsejtë 346 ditë pune.

Në SHFMU “I.K.” i ka në total 122 ditë pune, ku për vitin shkollor 2017 i ka 26 ditë pune, për vitin shkollor 2018 i ka 38 ditë pune, për vitin shkollor 2019 i ka 38 ditë pune dhe për vitin shkollor 2020 i ka 20 ditë pune, kurse SHFMU “Migjeni” në L.në total i ka 224 ditë pune, ku për vitin shkollor 2017 i ka 52 ditë pune, për vitin shkollor 2018 i ka 76 ditë pune, për vitin shkollor 2019 i ka 76 ditë pune dhe për vitin shkollor 2020 i ka 20 ditë pune.

Nga kërkesa e datës 03.11.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka bërë kërkesë tek e paditura për pagesë të udhëtimit, por nga përgjigja e Drejtorisë së Arsimit në Malishevë

nr.... e datës 30.11.2020 vërtetohet se e paditura e ka refuzuar, me arsyetimin se kërkesa është e pabazuar.

Gjatë analizimit të biletave të udhëtimit-kuponëve fiskal të lëshuara nga nga N.T.T “Korabi T.. 1”, është vërtetuar fakti se paditësi ka udhëtuar në relacionin Ll.-Carallukë dhe anasjelltas, dhe po ashtu ka udhëtuar edhe në relacionin Ll.-L. dhe anasjelltas dhe për të shkuar në SHFMU “Imer Krasniqi” në C. dhe në SHFMU “Migjeni” në L., prej vendbanimit të tij në Ll., ka shpenzuar nga 1 euro për biletë ditore në të dy drejtimet (0.50 euro në një drejtim), kurse në bazë të dokumentit-certifikatës së vendbanimit nr. ser. B ...të datës 09.10.2020 të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në D./Malishevë dhe kopjes së letërnjoftimit, vërtetohet fakti se paditësi vendbanimin e ka në Ll., komuna e Malishevës.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, parashtrësave për precizim, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi Blerim Krasniqi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe këtë nuk e ka mohuar as vetë e paditura.

Vërtetimet dhe kontratën e punës të cekura më lart, gjykata i ka pranuar si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj, kontratës së punës dhe vërtetimeve me të cilat është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe se paditësi në të dyja shkollat i ka 346 ditë pune për vitet shkollore 2017-2020, gjykata ua fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Sipas nenit 8 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve “*Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre*” ndërsa në dispozita e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se “*Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit, e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë*”, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*”, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit u vendos që të njëjtën ta aprovoj sipas periudhës-vitet shkollore 2017-2020 gjatë të

cilës paditësi ka punuar tek e paditura, fakt ky që u vërtetua edhe nga vërtetimet e lartcekura dhe në këtë gjendje të vërtetuar faktike, e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata ka gjetur se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr. 2056 të datës 18.04.2017 e cila ka qenë në fuqi deri me datën 21.01.2021 ku me nenin 35, paragrafi 5 përcaktohet se: *“Punëtorët arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës së caktuar, i paguhen 70 % të biletës së trafikut urban”*, ndërsa se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, dhe se themelësia e kërkesëpadisë e aprovuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi del e bazuar, gjykata është mbështetur edhe në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*, dhe nenit 90 par. 5 ku përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, pastaj lidhur edhe me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ku neni 3, paragrafi 2 përcakton se: *“I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”*.

Dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK) për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 - 21.01.2021, kurse të dispozitat e KKAK të vitit 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 - 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Duke u nisur nga fakti se paditura nuk e ka përmbushur obligimin e saj që del nga po e njëjta kontratë kolektive, përkatësisht me nenin 35 par.5, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj në rastin konkret gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Sa i përket lartësisë së shumës, gjykata u bazua në biletat e udhëtimit/kuponët fiskal me anë të të cilëve vërtetohet se paditësi ka udhëtuar nga vendbanimi i tij për në vendin e punës në të dy shkollat, ashtu që vendosi si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se për periudhën-vitin shkollor nga viti 2017 deri 2020 ose për gjithsejtë 346 ditë pune në të dy shkollat, paditësit i takojnë shpenzimet për udhëtim në shumën prej 242.20 euro dhe atë për çdo ditë pune nga 70% të biletës 1 euro, e që është 0.70 euro/cent (0.70 cent x 346 ditë pune = 242.20 euro). Pra, në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e udhëtimit për ditët sa ka qenë prezent në punë.

Lidhur me kundërshtimet e të paditurës në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike me të cilën do të duhej të refuzohej kërkesëpadija e paditëses. Pretendimet e të paditurës se i mungon legjitimiteti pasiv në procedurë me arsyetimin se Kontratën Kolektive të Arsimit e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, është e pabazuar sepse e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë.

E paditura lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, obligohet edhe në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa me dispozitën e par.1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*.

Në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit (mësimdhënësit) dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarin e saj në arsim. Pretendimet e të paditurës se Kontrata Kolektive është shkëputur dhe nuk prodhon efekt juridik nuk ka mbështetje ligjore, për faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi deri me datën 21.01.2021, kurse Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 ka qenë në fuqi deri me datën 21.11.2022 kur edhe është anuluar nga MASHT, kjo bazuar edhe në Mendimin Juridik për Shpërblimin Jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr.40/2023 të datës 27.02.2023.

Gjykata ka analizuar edhe pretendimet tjera të të paditurës, mirëpo ka vlerësuar se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe sikurse është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit dhe duke e llogaritur atë me kamatë ligjore prej 8 % nga data e marrjes së aktgjykimit, pasi ashtu është kërkuar në kërkesëpadi, edhe pse bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së dhe bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020 ka qenë dashur ti njihet nga data e parashtrimit të padisë, por sipas nenit 2 par. 2.1 të LPK-së: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën -II- të dispozitivit, gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe nenit 453 par.1 dhe 2 të LPK-së ku parashihet se: *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në*

gjq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”, si dhe në bazë të rregullores për tarifën e avokatëve, ashtu që vendosi që paditësit t’ia njoh shpenzimet e procedurës duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 99.00 euro dhe atë: në emër të parashtrimit të padisë t’ia paguajë shumën prej 78.00 euro (sipas numrit tarifor 6 të rregullores për tarifën e avokatëve në kontestet e vlerës së vogël nën 500.00 €) dhe shumën prej 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore (sipas tarifës së taksave gjyqësore), ndërsa kërkesa përtej kësaj shume është refuzuar, sepse me parashtrësën për precizim, paditësi vetëm i ka precizuar ditët e punës dhe periudhën për të cilën e ka kërkuar kompensimin dhe se këtë saktësim/precizim ka mundur ta bëjë edhe me padi, prandaj nuk mund të detyrohet pala e paditur për shpenzime të cilat janë krijuar me fajin e vet paditësit.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 398 lidhur me nenin 142 dhe 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.596/2021, datë 15.05.2024

Gjyqtari
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.